

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontejneri misterioz udhëtoi 62 ditë nga Brazili drejt Durrësit, detaje nga rrugëtimi i "mallit" të AMG Food
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/kontejneri-misterioz-udhetoi-62-dite-nga-brazili-drejt-durresit-detaj-i46597
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:17:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:59:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a017566c9f8084e5277d0bc23913265f4a4e52922dde7f3614d6786d190f7337
TEKSTI	164017667b8c042d5b42ee12219b62c7b8719c1bd5a020ca31153cb819f6c467
PAMJA	59f774910b59725cc0d43ca6ec3e0668b452840c2156c6387c5e4af404d36a3f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8e9e4007e6d6c72c38e86af81d6eeaebaefcfd3348672111ec1c654233806ca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8e9e4007e6d6c72c38e86af81d6eeaebaefcfd3348672111ec1c654233806ca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

[Kokaina e fshehur tek pulat e AMG Food, e grupit të Gert "gjeneralit"? Belgët zbardhin enigmën e 37 pakove të kapura në Portin e Durrësit](#)

15 Shtator 2026, 16:35

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 15 Shtator 2026, 16:59

Kontejneri misterioz udhëtoi 62 ditë nga Brazili drejt Durrësit, detaje nga rrugëtimi i "mallit" të AMG Food



Shkruar nga Versus



Konteneri frigoriferik i AMG Food në pronësi të Mondi Goxhajt ka bërë një rrugëtim prej 62 ditësh nga Brazili drejt Portit të Durrësit.

Hetuesit kanë nisur verifikimin e rrethanave të mbushjes së kontenerit me 37 pako kokainë, e fshehur mes mishit të pulës që importohet nga Brazili.

Sipas Policisë së Durrësit, kokaina e kapur, në rast se do të shitej në treg, do të kapte një vlerë rreth 2 milionë euro.

Dokumentacioni i ngarkesës e paraqiste atë si një kontejner me mish pule të ngrirë.

Hetimet po përqendrohen dhe në sqarimin se ku u furnizua konteneri me kokainë, në Brazil apo në ndalesat tranzitore dhe kush ishte personi ose grupi që do ta merrte ngarkesën në Shqipëri.

Hetimi duhet të përcaktojë gjithashtu, nëse droga është futur në kontejner pa dijeninë e importuesit apo nëse pas ngarkesës fshihet një skemë më e organizuar.

Rrugëtimi i kontenerit

Rrugëtimi nisi në Itajai, ku konteneri doli bosh nga depoja e Maersk, Seara Hub Itajai, më 14 korrik 2026. Më 29 korrik, ai hyri në terminalin JBS Terminais Itajai, ndërsa më 5 gusht u ngarkua në anijen MAERSK LOTA / 632N.

Anija u nis nga Itajai më 5 gusht në orën 15:20, duke nisur kështu pjesën kryesore të udhëtimit ndërkontinental. Pas afro 20 ditësh lundrim, MAERSK LOTA mbërriti në Port Tanger Med, Marok, më 24 gusht në orën 20:58.

Në Tanger Med, konteneri u shkarkua dhe qëndroi në port për rreth 8 ditë, përpara se të ngarkohej në anijen LUNA MAERSK / 633E më 1 shtator. Kjo anije u nis më 2 shtator në orën 04:48, me destinacion Mesdheun Lindor.

Më 7 shtator, konteneri mbërriti në Pire, Greqi, ku u shkarkua nga LUNA MAERSK. Pas rreth një dite e gjysmë, më 8 shtator, u ngarkua në anijen ushqyese (feeder) K OCEAN / 637N, e cila u nis nga Pireu më 9 shtator në orën 00:13.

Destinacioni final ishte Durrësi. Feeder-i K OCEAN mbërriti në portin e Durrësit më 12 shtator në orën 17:43. Konteneri u shkarkua më 13 shtator në orën 11:49, ndërsa më 13 shtator në orën 23:00 doli nga terminali. Më 14 shtator, në orën 12:35, u regjistrua hyrja përfundimtare në terminalin e Durrësit.

Nga nisja e anijes së parë nga Itajai, më 5 gusht në 15:20, deri në mbërritjen e KOCEAN në Durrës më 12 shtator në 17:43, kanë kaluar rreth 38 ditë e 2 orë nga nisja e parë detare deri në mbërritjen në portin shqiptar.

Por konteneri nuk ka qenë vazhdimisht në det. Gjatë rrugës ka pasur qëndrime dhe operacione në portet e Tanger Med dhe Pireut, ku është shkarkuar dhe ringarkuar në anije të tjera.

Në total, nga dalja nga depoja në Itajai më 14 korrik deri në hyrjen në terminalin e Durrësit më 14 shtator, udhëtimi i këtij konteneri zgjati rreth 62 ditë.

Emri i AMG Food ishte bërë i njohur më herët për një tjetër çështje të rëndë.

Më 11 mars 2025, kompania importoi nga Brazili një ngarkesë me mish pule. Sipas të dhënave të publikuara nga autoritetet dhe mediave, në analizat laboratorike u konstatua prania e bakterit Salmonella Typhimurium.

Sasia e referuar zyrtarisht në atë periudhë ishte rreth 7.9-8 tonë, ndërsa burime mediatike raportuan se ngarkesa totale e filetos së pulës mund të arrinte deri në 18.3 tonë.

Mishi kishte mbërritur në Portin e Durrësit më 11 mars.

AKU kishte marrë mostra për analiza dhe laboratorit i ISUV nxori përgjigjen më 21 mars, duke konstatuar salmonelën.

Sipas kompanisë AMG Food, produkti ishte shitur te 154 klientë, ndërsa u siguruan faturat e shitjeve për të mundësuar gjurmimin dhe tërheqjen e tij.

AKU raportoi se rreth 4.5 tonë ishin tërhequr nga tregu, ndërsa pjesa tjetër po kërkohej në pika të ndryshme të vendit

Poll





AKTUALITET

[Kokaina e fshehur tek pulat e AMG Food, e grupit të Gert “gjeneralit”? Belgët zbardhin enigmën e 37 pakove të kapura në Portin e Durrësit](#)

15 Shtator 2026, 16:35

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[Ceremonia shtetërore në Beograd për Ratko Mlladiç, Marta Kos dënon glorifikimin e kriminelëve të luftës](#)

15 Shtator 2026, 16:14

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[I akuzuar për trafik ndërkombëtar të drogës, vrasje dhe pastrim parash, Brazili miraton ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë](#)

15 Shtator 2026, 15:47

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve](#)

15 Shtator 2026, 15:17

[^ekstrakti^](#)





AKTUALITET

[Gjykata e Lartë dhe KLP kundër pr/ligjit për pagat e propozuara në Kuvend: Nuk reflekton standardin e Kushtetueses](#)

15 Shtator 2026, 15:05

^ekstrakti^



AKTUALITET

["Sillini në shtëpi", sheshet e rrugët e Kosovës mbushen me mbishkrime për 4 ish-krerët e UÇK-së](#)

15 Shtator 2026, 14:47

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Shiste drogëra të forta në Durrës, arrestohet 21 vjeçari! I gjenden qindra doze her*ine e kokaine](#)

15 Shtator 2026, 14:00

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Kultivoi kanabis në tokë shtetërore, arrestohet 41 vjeçari në Mallakastër](#)

15 Shtator 2026, 13:07

^ekstrakti^

Të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.